

**LIGJ PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PER DOKUMENTE ELEKTRONIKE, IDENTIFIKIM
ELEKTRONIK DHE SHERBIME TE BESUESHME**

Neni 1

Ne Ligjin per dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe sherbime te besueshme ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise se Veriut" numer 101/19), ne nenin 7 pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafe te rinj (3) dhe (4), si ne vijim:

"(3) Dokumentet elektronike permbajne elemente obliguese.

(4) Elementet obliguese te dokumenteve elektronike i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrate me rregullore."

Neni 2

Neni 20 ndryshohet si vijon:

"(1) Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates mund te regjistroje ne Regjistrin e dhenesve te sherbimeve te besueshme dhe te skemave per identifikim elektronik edhe persona juridike te huaj te cilet jane te regjistruar si dhenes te sherbimeve te besueshme ose si dhenes te skemave per identifikim elektronik ne nivel te Bashkimit Evropian ose ne vendin anetar te Bashkimit.

(2) Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates mund te regjistroje ne Regjister edhe skema per idenfikim elektronik qe i pergjigjen nivelit te larte te sigurise, nese ajo skeme perdoret nga vendi anetar i Bashkimit Evropian.

(3) Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates mund te regjistroje ne Regjistrin e dhenesve te sherbimeve te besueshme dhe te skemave per identifikim elektronik edhe persona juridike te huaj te cilet jane te regjistruar si dhenes te sherbimeve te besueshme ose si dhenes te skemave per identifikim elektronik ne shtet tjeter qe nuk eshte vend anetar i Bashkimit Evropian, ne baze te marreveshjes se lidhur paraprakisht me te cilen percaktohet reciprociteti i skemave per identifikim elektronik ose/dhe i dhenesve te sherbimeve te besueshme ndermjet Republikes se Maqedonise se Veriut dhe shtetit ne te cilin eshte regjistruar personi juridik."

Neni 3

Ne nenin 56 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Certifikata e kualifikuar per autenticitet te ueb fageve e leshuar nga dhenesi i sherbimit te kualifikuar te besueshem i regjistruar ne Bashkimin Evropian apo ne vendin anetar te Bashkimit njihet si te jete leshuar nga person juridik i vendit."

Neni 4

Neni 74 ndryshohet si vijon:

"(1) Nenshkrimet elektronike, vulat elektronike dhe vulat katrore te perkohshme elektronike te leshuara deri ne ditene fillimit te zbatimit te ketij ligji ne pajtim me Ligjin per te dhenat ne forme elektronike dhe nenshkrim elektronik, vazhdojne te vlejne deri ne skadimin e vlefshmerise se tyre.

(2) Personat juridike te cilet ushtrojne veprimtari deri ne ditën e fillimit te zbatimit te ketij ligji ne pajtim me Ligjin per te dhena ne forme elektronik dhe nenshkrim elektronik, me hyrjen ne fuqi te ketij ligji do te vazhdojne t'i japin nenshkrimet elektronike dhe do t'i sigurojne sherbimet ne pajtim me Ligjin per te dhenat ne forme elektronike dhe nenshkrim elektronik.”.

Neni 5

Ne nenin 75 paragrafet (1) dhe (2), ndryshohen si ne vijim:

“(1) Dhenesit e sherbimeve te besueshme, perkatesisht dhenesit e certifikatave te cilet ushtrojne veprimtari ne baze te Ligjit per te dhena ne forme elektronike dhe nenshkrim elektronik jane te obliguar ta harmonizojne punen e tyre me dispozitat e ketij ligji me se voni deri me 1 shtator 2020.

(2) Ne periudhen deri ne harmonizim me dispozitat e ketij ligji, dhenesit e sherbimit te besueshem nga paragrafi (1) i ketij neni, perkatesisht dhenesit e certifikatave i sigurojne sherbimet per leshim te certifikatave per nenshkrime elektronike, vula elektronike dhe vulat katrore te perkohshme elektronike me Ligjin per te dhenat ne forme elektronike dhe nenshkrim elektronik.”.

Neni 6

Ne nenin 78 fjalet: “ndersa do te filloje te zbatohet ne afat prej nje viti nga dita e miratimit te akteve nenligjore te percaktuara me kete ligj” zevendesohen me fjalet: “ndersa do te filloje te zbatohet nga 1 shtatori 2020, pervec dispozitave nga kapitulli II. Dokumenti elektronik qe do te fillojne te zbatohen nga 20 dhjetori 2019”.

Neni 7

Rregullorja e percaktuar me nenin 1 te ketij ligji do te miratohet me se voni deri ne ditën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn ne fuqi ne ditën e botimit ne “Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise se Veriut”